



Portali

Bibla Shqip

Materiale

Apologjia

Fete & Kultet

Burime-Info

Kush Jemi

Abonohuni

Vizioni ynë:

*"Që t'ju shërbejmë
shqiptarëve për
Krishtin."*

Historia e Ungjillorëve në Shqipëri

Nga Pastor Akil Pano

Cilat janë vlerat historike dhe tradita frymerore të Kishës Ungjillore në Shqipëri?

Si paraqitet Komuniteti Ungjillor në Shqipëri në realitetin e vitit 2006?

Lexo me tej duke klikuar [KETU](#)

Derë e Hapur! ([versioni online](#))

A ju është mbyllur ndonjëherë dera për ndonjë situatë në jetën tuaj? A jeni ndjere ndonjëherë si të mbyllur në një kuti? A jeni ndjere ndonjëherë të përjashtuar nga ndonjë mundësi?

Nesë ndonjëri mund të jetë ndjere në këto mënyra, e njëjta gjë ndodhi me Shadrakun, Meshakun dhe Abednegon të cilët jetuan sipas ligjit të Mbretit Nebukadnezari të Babilonisë. Kur Nebukadnezari i dha atyre ultimatumin "adhuroni imazhin e arit ose do të shkonin në furrën e zjarrit", ata padyshim u ndjeshin si të futur në një kuti. Ata mund të kishin mohuar Zotin dhe të adhuronin një idhull ose të qëndronin në Zotin dhe të ishin vrarë.

Nebukadnezari nuk mori parasysh dy gjëra – përgjigjen e Shadrakut, Meshakut dhe Abednegos dhe fuqinë e Zotit.

"Ja Perendia yne të cilit i shërbejmë është në gjendje të na cliroje nga furra e ndezur dhe do të na cliroje nga dora jote o mbret. Por edhe sikur të mos e bente, dije o mbret që ne nuk do të shërbejmë perendive të tua dhe nuk do të adhurojmë figurën e arte që ti ke ngritur". Danieli 3:17-18

Ata besuan Zotin që është në gjendje të hapë dyert, Zoti i cili i ruajtë ata gjallë për të adhuruar Atë dhe për të sjellë Nebukadnezarin në gjunjë të frikesuar.

Në fakt Perendia yne është dera e hapur. "Une jam dera për delet" tha Jezus Krishti. "Ja të vura përpara një derë të hapur që asnjëri nuk mund ta mbyllë". Zbulesa 3:7

"Ja une po bëj një gjë të re, ajo do të leshojë degë" Isaia 43:19. Kenga e adhurimit nga Don Moen thotë: "Zoti do të bëjë një rrugë aty ku duket se nuk ka rrugë". Besoni Jezus Krishtin që të hapet një derë në jetën tuaj dhe fuqinë e tij për t'ju dhënë një të ardhme dhe shpresë.

E Drejta e Autorit 2006 E. Stanley Ott

Fjalori biblik ([versioni online](#))

Akuzuesi

Satani eshte quajtur "paditesi i vellezerve" (Zb 12:10. Krahaso: Jobi 1:6; Zak 3:1), duke ushtruar influencen e tij mes njerezve dhe duke sjelle akuza te rreme kunder te Krishtereve me qellim qe te dobesoje influencen e tyre dhe te demtoje qellimin qe i identifikon ata. Ai eshte konsideruar nga Judenjte si paditesi i njerezve para Perendise, duke i paditur ata per shkelje te ligjit, gje per te cilen ata ishin fajtores dhe e meritonin denimin.

Humnere

Vendi ku Perendia dergon frymrat e liga per te Banuar (Luka 8:31), vend ku mbahen gjithashtu edhe frymerat e pabindura (Zb 9:1-2; 20:1-3). Eshte menduar se ky vend ndodhej ne thellesiste e tokes.

Amen

Fjale me origjine Hebraike qe do te thote "drejt" me kuptimin "besnik" (Zbulesa 3:14) "me te vertete eshte keshtu". Perdoret zakonisht ne fund te lutjeve (Ps. 41:13; 72:19; 89:52), per te konfirmuar fjalet e thena dhe per te nxitur permushjen e tyre. Premtimet e Zotit jane Amen, dmth ato jane te gjitha te verteta dhe te sigurta (2 Korintasve 1:20)

Abadon

Shkaterrim. Ne hebraisht (fjala ekuivalente ne Greqisht eshte Apollyon, qe do te thote shkaterrimtar) eshte emir i "engjellit te humneres" (Zbulesa 9:11). Ne pasazhet e meposhtme fjala eshte ekuivalente me fjalen "Shkaterrim" (Job. 26:6; 28:22; 31:12; Fjalet e Urta 15:11; 27:20). Shpesh here kjo fjale personifikon Hadesin ose Sheolin.

Shenim: Fjalori eshte nje projekt ne vazhdim e siper. Mirepresim te gjitha pyetjet, sugjerimet dhe keshillat tuaja. [Na Kontaktoni](#)



albKristian.com

E-mail: buletini@albKristian.com

Kush Jemi: [Stafi i albKristian.com](#)

Copyright © albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare

Buletini albKristian.com eshte nje sherbese e albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare. Nuk lejohet asnje lloj perdorimi per qellime fitimi apo komerciale te cfaredo lloj forme. Mund te printohet, shperndahet dhe perdoret falas ose per qellime jofitimpruresse pa lejen e autorit. Per cdo lloj perdorimi tjeter ju lutem na kontaktoni paraprakisht per leje.